



Republika e Kosovës Republika
Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
/ Ministry of Culture, Youth and Sports

Prishtinë, 03 Gusht 2022

THIRRJA PËR PROJEKT - PROPOZIMET PER RINI

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në fushën e rinisë për vitin 2022 rendit ndër prioritetet programore fuqizimin e të gjithë të rinjve në jetën ekonomike dhe sociale të vendit duke avancuar politikat, programet dhe bashkëpunimin ndër-institucional.

Në funksion të prioritetit programor, thirrja për projekt-propozimet për vitin 2022 që mbulon fushën e rinisë synon mbështetjen e projekt-propozimeve të OJQ- ve që zhvillohen në Republikën e Kosovës apo në shtetet e tjera, të cilët përmbushin objektivat e përgjithshme si në vijim:

- Mobilizimi dhe ngritja e shkathtësive të rinjve për pjesëmarrje përfaqësim dhe qytetari aktive;
- Ngritja e kapaciteteve dhe shkathtësive të të rinjve për të siguruar një përgatitje adekuate për tregun e punës dhe promovimi i vlerave demokratike dhe qytetarisë aktive tek të rinjtë përmes edukimit;
- Ngritja e kapaciteteve për organizatat rinore dhe mekanizmat tjerë rinor, në mënyrë që të jenë të aftë të sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre operacionale, programore, financiare dhe organizative për të qenë efektive në përmbushjen e misionit të tyre;
- Rritja e vetëdijes dhe krijimi i kushteve për një rini të sigurt dhe të shëndetshme;
- Organizimi i shënimit të Vitit Evropian të Rinisë 2022;
- Zhvillimi i hulumtimit, dokumentimit në fushën e rinisë;

Projekt-propozimet e zhvilluara në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të synojnë gjithëpërfshirjen duke siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të komunitetit rinor në aktivitetet përkatëse të projekt-propozimit, në veçanti të rinjtë, të moshuarit, vajzat dhe gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin LGBTIQ, komunitetet pakicë etj.

Të drejtë aplikimi me projekt-propozime në thirrjen publike për vitin 2022 kanë OJQ-të që dëshmojnë se programi i tyre i punës është i profilizuar në fushën e rinisë. OJQ-të mund të aplikojnë vetëm në njëren nga kategoritë në vijim:

- 1. Projektet dhe ngjarjet në fushën e rinisë;**
- 2. Organizimi i shënimit të Vitit Evropian të Rinisë 2022;**
- 3. Trajnim për organizatat rinore dhe mekanizmat tjerë rinor, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të profesionistëve në fushën e rinisë;**

OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti 1 projekt-propozim në një nga tre kategoritë e kësaj thirrje publike.

Tre kategoritë e listuara më sipër janë elaboruar më poshtë, duke zbërthyer synimet dhe aktivitetet përkatëse, fushëveprimin, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për aplikuesit, si dhe shkallën maksimale dhe minimale të mbështetjes.

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:

Vlerësimi administrativ, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

Vlerësimi përmbajtësor, që vlerëson

- Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën e rinisë;
- Nëse aplikuesi ka respektuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e programit përkatës në vitet paraprake;
- Nëse aplikuesi ka paraparë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të paraqitur në këtë thirrje publike;
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrje publike;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;

- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Aplikimi: Propozim

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në web – faqen e MKRS-së: www.mkrs-ks.org
Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Sheshi Nëna Terezë; Zyra e Arkivës, Nr. 22; 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës është i detajuar në Udhëzimet për aplikuesit.

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (e shtypur dhe CD)
2. Formulari i Propozim buxhetit (e shtypur dhe CD)
3. Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (e shtypur)
4. F12 Formular i deklaratës se partneritetit doc (e shtypur nëse aplikohet)
5. F13 Forma e deklaratës se projekteve te financuara.doc (e shtypur)
6. F14 Deklaratë pranimi për kryerjen e aktiviteteve në projekt (e shtypur)
7. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
8. Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
9. Kopja e konfirmimit të llogarisë bankare në emër të OJQ-ës
10. Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar të OJQ-ës
11. Vërtetimi tatimor nga ATK që vërteton se OJQ nuk ka obligime ndaj tyre (para nënshkrimit të kontratës)
12. Certifikatë nga Gjykata për personin përgjegjës të projektit që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe nuk është dënuar nga gjykata (para nënshkrimit të kontratës)
13. Certifikatë nga Gjykata për OJQ-ën që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe nuk është dënuar nga gjykata (para nënshkrimit të kontratës).

Afati për aplikim:

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së kësaj thirrje publike dhe përfundon me datën: **24 gusht 2022, në ora 16:00.**

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: zorka.stolic@rks-gov.net; vedat.jashari@rks-gov.net; kreshnik.xharra@rks-gov.net;

KATEGORIA E PARË:

Projektet dhe ngjarjet në fushën e rinisë

Synimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është fuqizimi i të gjithë të rinjve në jetën ekonomike dhe sociale të vendit duke avancuar politikën, programet dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

Në këtë kategori parashihet mbështetja e projekt-propozimeve të OJQ-ve të profilizuar në fushën e rinisë, me synim:

3.1 Ngritja e vetëdijes dhe mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive. Aktivitetet specifike që jetësojnë këtë synim mund të konsiderohen:

- Ngritja e kapaciteteve të zhvillimit organizativ të organizatave rinore;
- Organizimi i fushatave të vetëdijesimit që promovojnë dhe kontribuojnë në ndërgjegjësimin për të drejtat dhe përgjegjësitë e të rinjve;
- Organizimi i aktiviteteve që kontribuojnë në vetëdijesimin dhe promovojnë mekanizmat ligjor për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse;
- Organizimi i aktiviteteve që promovojnë dhe nxisin aktivizmin rinor në komunitet / mobiliteti rinor;
- Promovimi i diversitetit kulturor të Kosovës, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të të rinjve nga zona dhe komunitete të ndryshme etnike në fushën e artit, trashëgimisë kulturore, e sportit;
- Zhvillimi i programeve që promovojnë vullnetarizmin dhe rolin e punës vullnetare;
- Zhvillimi i hulumtimeve në lidhje me gjendjen e sektorit të rinisë në relacion me legjislacionin mbi pjesëmarrjen, dhe monitorimi i zbatueshmërisë së bazës ligjore në lidhje me pjesëmarrjen aktive të rinjve;
- Të tjera.

3.2 Ngritja e kapaciteteve dhe shkathtësive të rinjve për të siguruar një përgatitje adekuate për tregun e punës dhe Promovimi i vlerave demokratike dhe qytetarisë aktive tek të rinjtë përmes edukimit. Aktivitetet specifike që jetësojnë këtë synim mund të konsiderohen:

- Organizimi i ngjarjeve për promovimin e edukimit jo formal që çojnë drejt edukimit;
- Trajnime profesionale afatshkurta që janë në përputhje me nevojat e tregut të punës (*me theks të veçantë për të rinjtë për kategorinë NEET*);

- Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për orientim në karrierë dhe treg adekuat të punës;
- Organizimi dhe përkrahja e panairëve për informimin e të rinjve mbi rëndësinë dhe nxitjen e tyre për kyçje në tregun e punës;
- Organizimi i ngjarjeve promovuese me komunitetin e biznesit dhe palët tjera të interesit për mundësitë e punësimit dhe të vetëpunësimit të të rinjve;
- Të tjera.

3.3. Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurt për të rinjtë. Aktivitetet specifike që jetësojnë këtë synim mund të konsiderohen:

- Organizimi i ngjarjeve që kontribuojnë në ndërgjegjësimin për dukuritë negative që cenojnë shëndetin e rinisë dhe promovojnë mjedisin të shëndetshëm;
- Organizimi i fushatave, trajnimeve, punëtorive, debateve dhe aktiviteteve të tjera, të cilët promovojnë mënyrën e shëndetshme të jetesës tek të rinjtë, duke përfshirë ushqimin e shëndetshëm, shëndetin mendor, parandalimin e dhunës psikike dhe fizike, përdorimin e substancave të dëmshme, rolin e aktiviteteve fizike duke promovuar mjedisin e shëndetshëm;
- Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të institucioneve qendrore dhe lokale të sektorëve të rinisë për kanosjet dhe ruajtjen e mjedisit të sigurt për të rinjtë;
- Ndërgjegjësimi i rinisë për dukuritë negative shoqërore si trafikimi, ekstremizmi, kriminaliteti etj. përfshirë edhe hapat për parandalimin e këtyre dukurive;
- Rritja e kohezionit social ndëretnik në mes të rinjve;
- Mbështetja e femrave në zonat rurale;
- Të tjera.

3.4. Zhvillimi i hulumtimit, dokumentimit në fushën e rinisë. Aktivitetet specifike që jetësojnë këtë synim mund të konsiderohen:

- Zhvillimi i hulumtimeve, kërkimeve dhe prezantimeve në medime të ndryshme me temë:
- Shëndeti Mendor i të rinjve;
- Ndikimi negativ i internetit te të rinjtë;
- Hulumtim mbi gjendjen e përgjithshme mbi përdorimin e medias nga të rinjtë;
- Organizimi i një punëtorie për media në tematikën e rinisë;
- Organizimi i konferencave, simpoziumeve dhe tryezave hulumtuese;
- Të tjera.

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës apo në shtetet ku është e koncentruar diaspora, të profilizuara në fushën e rinisë, me përvojë të dëshmuar në sektorin e rinisë,

që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;

Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora sipas legjislacionit ekuivalent për regjistrimin e organizatave jo-për-përfitim në vendin përkatës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-të e diasporës të regjistruara në vendin e huaj;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Të ofroj dëshmi se OJQ-ja ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. *(Nga kjo pikë përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021);*
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

Kriteret e veçanta për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e rinisë, me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve rinore. Në vlerësim mund të konsiderohet edhe përvoja individuale e anëtarëve të organizatës nëse OJQ-ja është e themeluar rishtazi);
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të aktiviteteve në fushën e rinisë gjatë të paktën 2 viteve të fundit;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (skema organizative, stafi-CV dhe diplomat përkatëse, hapësirat e punës, pajisjet teknologjike etj);

- Të ofrojnë pasqyrat financiare për të paktën 2 vitet e fundit, përkatësisht vitet 2020 dhe 2021;
- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 10,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 5,000.00 Euro

KATEGORIA E DYTË: (Në këtë kategori do të përzgjidhet vetëm 1 OJQ fituese)

Organizimi i shënimit të Vitit Evropian të Rinisë 2022

Synimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është gjallërimi dhe begatimi i jetës së të rinjve, përmes mbështetjes së ngjarjeve të mëdha e gjithëpërfshirëse kulturore në Republikën e Kosovës.

Kjo kategori synon mbështetjen e organizimit të veçantë i cili ndërlidhet drejtpërdrejtë me Shënimin e Vitit Evropian të Rinisë 2022.

Në bazë të vendimit të Këshillit dhe Parlamentit Evropian, viti 2022 është shpallur Viti Evropian i Rinisë. Viti Evropian i Rinisë ka katër objektiva kryesore:

- Theksimi i mundësive të ofruara nga tranzicioni i gjelbër dhe dixhital, për rinië;
- Mbështetja e të rinjve për t'u bërë qytetarë aktiv dhe të angazhuar;
- Promovimi i mundësive për të rinjtë;
- Sjellja e perspektivës së të rinjve në politikat e Bashkimit Evropian.

Përmes organizimit të programeve dhe aktiviteteve të ndryshme shtetet përkushtohen në fuqizimin e rinisë, përmes fuqizimi të përfshirjes së të rinjve si akter të ndryshimit për zhvillim demokratik, për mbrojtje të mjedisit, dhe diversitetit kulturore. Theks i veçantë i kushtohet edhe fuqizimit të mobilitetit të vullnetarëve të rinj, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për rolin e vullnetarizimit në shoqëritë demokratike dhe pjesëmarrje aktive në procese.

Me qëllim të plotësimit të objektivave të përcaktuara për Vitin Evropian të Rinisë, në kuadër të kësaj kategorie ofrohet mbështetja e aktivitetit specifik në vijim:

- **Organizimi i një kampi 5 ditorë për të rinjtë me temën: “Një e ardhme e përbashkët Evropiane - me theks të veçantë ndryshimet klimatike, mbrojtja e mjedisit, burimet e ripërtërishe”, në përputhje me objektivat kryesore të Vitit Evropian të Rinisë 2022.**

Shënim: 50-70 të rinj duhet të jenë pjesë e ngjarjes;

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara dhe me përvojë të dëshmuar në sektorin e rinisë, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së

Kosovës;

- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Të ofroj dëshmi se OJQ-ja ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. *(Nga kjo pikë përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021);*
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e rinisë, me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve rinore;
- Të ofrojnë portfolio me dëshmi të mbarëvajtjes së aktiviteteve në fushën rinisë së paku 5 vite me radhë;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore - CV dhe diplomat përkatëse, hapësirat e punës, pajisjet teknologjike etj);
- Të ofrojnë pasqyrat financiare për të paktën 2 vitet e fundit, përkatësisht vitet 2020 dhe 2021;
- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 20,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 10,000.00 Euro

KATEGORIA E TRETË: (Në këtë kategori do të përzgjidhet vetëm 1 OJQ fituese)
Mbështetje institucionale për organizatat rinore dhe mekanizmat tjerë rinor

Synimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është fuqizimi i të gjithë të rinjve në jetën ekonomike dhe sociale të vendit duke avancuar politikat, programet dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

Në këtë kategori parashihet mbështetja e projekt-propozimeve të OJQ-ve të profilizuar në fushën e rinisë, me synim:

3.1. Ngritja e kapaciteteve për organizatat rinore dhe mekanizmat tjerë rinor, në mënyrë që të jenë të aftë të sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre operacionale, programore, financiare dhe organizative për të qenë efektivë në përmbushjen e misionit të tyre

MODULI 1

Ideimi i projektit/Identifikimi i nevojave reale të grupit që shërben;
Aplikimi në grante (aplikacioni dhe projekti – propozimi);

MODULI 2

Planifikimi dhe menaxhimi financiar (përfshire tatimet dhe kontributet);
Raportimi i rregullt dhe llogaridhënia;
Organizimi dhe qeverisja e brendshme;

MODULI 3

Gjithë përfshirja (gjinore, etnike, mendore dhe fizike);
Përfshirja dhe rekrutimi i vullnetarëve. Prezantimi i KOVOS;

MODULI 4

Strategjitë e komunikimit;
Teknikat e Avokimit dhe Lobimit;
Komunikimi dhe promovimi i jashtëm;

Trajnimi ka për qëllim avancimin e infrastrukturës njerëzore, forcimin e mekanizmave rinorë,

ngritjen e kapaciteteve në fushat respektive të trajnimit, në mënyrë që mekanizmat rinorë të jenë të aftë të sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre operacionale, programore, financiare dhe organizative për të qenë efektivë në përmbushjen e misionit të tyre.

Në programin e trajnimit për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale të mekanizmave rinor duhet të përfshihen 2 përfaqësues të deleguar nga (Organizatrat Rinore, Qendrat Rinore, KVRL-të, KQVR-së, dhe mekanizmave tjerë rinor)

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara dhe me përvojë të dëshmuar në sektorin e rinisë, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Të ofroj dëshmi se OJQ-ja ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. *(Nga kjo pikë përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021);*
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e rinisë, me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve rinore;

- Të ofrojnë portfolio me dëshmi të mbarëvajtjes së aktiviteteve në fushën rinisë së paku 5 vite me radhë;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore - CV dhe diplomat përkatëse, hapësirat e punës, pajisjet teknologjike etj);
- Të ofrojnë pasqyrat financiare për të paktën 2 vitet e fundit, përkatësisht vitet 2020 dhe 2021;
- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Shkalla e mbështetjes:

- | | |
|---------------------------------------------------|----------------|
| • Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues | 20,000.00 Euro |
| • Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues | 10,000.00 Euro |